

# **RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE - RIZGJEDHJE TË MËSIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRRRJET MËSIMORE-SHKENCORE, THIRRRJET MËSIMORE-SHKENCORE PËR LËNDËT PROFESIONALE-ARTISTIKE DHE NË THIRRRJE TË BASHKËPUNËTORËVE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, më datë 15 Shkurt 2020 në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës si dhe në gazetat ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” është shpallur Konkurs për zgjedhje të një asistenti për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës. Në bazë të Konkursit në fjalë, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 10 Prill 2020 ka formuar Komision recensues për zgjedhjen e një asistenti për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë (në programet studimore Ekonomi dhe Biznes, Financa dhe Kontabilitet, Marketing dhe Menaxhment, Biznes Ndërkombëtar dhe Turizëm) në përbërje:

1. Prof.dr. Naser Raimi - Profesor ordinar në Fakultetin e Administrimit të Biznesit pranë Universitetit të Tetovës, anëtar;
2. Prof.dr. Brikend Aziri - Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, kryetar dhe
3. Prof.dr. Sali Zhaku - Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, anëtar.

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar në konkurs, komisioni në fjalë vërtetoi se ka aplikuar vetëm një kandidat, edhe atë:

1. Mr. Valon Ameti

Pas shqyrtimit të vëmendshëm të dokumentacionit, Komisioni erdhi në përfundim se kandidati Mr. Valon Ameti ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit dhe i plotëson të gjitha kushtet e parapara komfor Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018) dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës.

Duke patur parasysh të më lartën, komisioni ka vendosur të del me këtë:

## **RAPORT RECENSUES**

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, më datë 15 Shkurt 2020 në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës si dhe në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” është shpallur Konkurs për zgjedhje të një asistenti për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës. Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar ka ardhur në përfundim se komfori i kërkesave të konkursit të shpallur ka aplikuar vetëm një kandidat, Mr. Valon Ameti, dhe i njëjti në tërësi i plotëson të gjithë kushtet dhe kriteret e parapara me kërkesat e konkursit, dispozitat ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe normativën interne të Universitetit të Tetovës.

### **Të dhëna biografike dhe ngritja profesionale**

Mr. Valon Ameti ka lindur më 24.10.1995 në Tetovë. Në vitin 2014 me sukses përfundon shkollën e mesme në “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë. Më 01.10.2014 regjistron studimet deri-diplomike në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës në programin studimor “Marketing dhe menaxhment”, e të cilat i përfundon me sukses më datë 15.09.2018 duke marrë thirrjen Ekonomist i diplomuar në fushën e marketingut dhe menaxhmentit. Më 15.11.2018 regjistron studimet pasdiplomike në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës në programin studimor Marketing të cilat i përfundon me sukses më datë 24.12.2019 duke marrë gradën e Magjistrisë të Shkencave Ekonomike në fushën e Marketingut. Mr. Valon Ameti deri më tani ka akumuluar përvojë në cilësinë e demonstratorit në lëndë nga fusha e ekonomisë në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës në vitet akademike 2018/2019 dhe 2019/2020. Duhet veçuar posaçërisht përfundimin me sukses të US Leadership and English Language Training Program në organizim të Northern Illinois University, College of Business, DeKalb në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe përfundimin me sukses të seminarit në Marketing dhe Komunikime në International Business Management Institute në Berlin në Gjermani. Ai gjithashtu në periudhën 27/04/2017 – 27/04/2019 ka shërbyer si Menaxher në KFF Tetova 2017. Krahas gjuhës shqipe, kandidati njeh në nivel akademik edhe gjuhën maqedone dhe atë angleze.

### **Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore**

Mr. Valon Ameti ka trasuar me sukses rrugën për angazhim potencial akademik duke manifestuar kapacitete adekuate për të zhvilluar mësimdhënien dhe duke nxitur mësimnxënien e studentëve. Ai në periudhën e viteve akademike 2018/2019 dhe 2019/2020 ka qenë i angazhuar në cilësinë e demonstratorit në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës. Ai ka servisuar me sukses lëndët: Bazat e marketingut, Bazat e menaxhmentit dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore.

### **Përfundimi dhe propozimi**

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues

i vlerëson pozitivisht aktivitetet e realizuara nga ana e kandidatit dhe konkludon se Mr. Valon Ameti në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për zgjedhje në cilësinë e asistentit për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni recensues konstaton se: Mr. Valon Ameti posedon cilësi shkencore-profesionale bazuar në Ligjin për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, me çka ai plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, që kandidati Mr. Valon Ameti të zgjidhet asistent për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës .

04.05.2020

Tetovë

ANËTAR TË KOMISIONIT RECENSUES

Prof. dr. Brikend Aziri, Kryetar



---

Prof. dr. Naser Raimi, Anëtar



---

Prof.dr. Sali Zhaku, Anëtar



Shtojcë -formulari i referencave për zgjedhje në thirrje mësimore

Kandidati: Valon Ameti

Institucioni: Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës.

Lëmi Shkencorë: Shkenca Ekonomike

<b>1. Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore Ushtrime të zhvilluara në studimet e ciklit të parë Viti akademik 2018/2019 Semestri dimërorë</b>		
Bazat e marketingut	2x15x0.03	0.9
Bazat e menaxhmentit	2x15x0.03	0.9
<b>Semestri verorë</b>		
Bazat e marketingut	2x15x0.03	0.9
Bazat e menaxhmentit	6x15x0.03	2.7
<b>Viti akademik 2019/2020</b>		
<b>Semestri dimërorë</b>		
Bazat e marketingut	4x15x0.03	1.8
Bazat e menaxhmentit	5x15x0.03	2.25
<b>Semestri verorë</b>		
Bazat e marketingut	2x15x0.03	0.9
Bazat e menaxhmentit	4x15x0.03	1.8
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2x15x0.03	0.9
Gjithsej pikë nga mbajtja e ushtrimeve në ciklin e parë të studimeve	13.05	
<b>Përkatitje e lëndës së re</b>		
<b>Ushtrime</b>		
Bazat e menaxhmentit		1.5
Bazat e marketingut		1.5
Menaxhimi i burimeve njerëzore		1.5
Gjithsej pikë nga përpilimi i ushtrimeve në lëndë të re	4.5	
<b>Konsultime me studentë</b>		
<b>Viti akademik 2018/2019</b>		
<b>Semestri dimërorë</b>		
Bazat e marketingut	25x0.002	0.05
Bazat e menaxhmentit	15x0.002	0.03
<b>Semestri verorë</b>		
Bazat e marketingut	45x0.002	0.09
Bazat e menaxhmentit	55x0.002	0.11

Viti akademik 2019/2020		
Semestri dimërorë		
Bazat e marketingut	55x0.002	0.11
Bazat e menaxhmentit	45x0.002	0.09
Semestri verorë		
Bazat e marketingut	10x0.002	0.02
Bazat e menaxhmentit	75x0.002	0.15
Menaxhimi i burimeve njerëzore	30x0.002	0.06
Gjithsej pikë nga konstultat me studentë		0.71
GJITHSEJ PIKE NGA MESIMDHENIA DHE VEPRIMTARIA ARSIMORE		18.26

Veprimtaria me interes më të gjerë	Pikët
Qëndrime studimore	
US Leadership and English Language Training Program	1
GJITHSEJ PIKE NGA VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	1

04.05.2020  
Tetovë

ANËTAR TË KOMISIONIT RECENSUES

Prof. dr. Brikend Aziri, Kryetar



Prof. dr. Naser Raimi, Anëtar



Prof.dr. Sali Zhaku, Anëtar

